

**SHOQËRIA “DIJON ALBANIA” Sh.a.**  
**Regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT K81805011P**

---

**VENDIM**  
**i Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë**  
**“DIJON ALBANIA” Sh.a.**

Ky vendim u mor sot me date 22/03/2023, në selinë e shoqërisë “DIJON ALBANIA” Sh.a. Në këtë mbledhje marrin pjesë aksionerët e shoqërisë që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë:

- **Z. Dritan Pashako**, - zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë,

Rendi i ditës është:

- 1) Miratimi i shitjes së 3% të kuotave të kapitalit të shoqërisë të zotëruara nga aksioneri Z. Dritan Pashako;
- 2) Të tjera eventuale;

Në bazë të **Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008** “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, Asambleja e aksionerëve të shoqërisë

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shitjes së 3% të kuotave të kapitalit të shoqërisë të zotëruara nga aksioneri Z. Dritan Pashako, tek Znj. Emi Gliozheni.
2. Miratimin e termave dhe kushteve të Marrëveshjes së transferimit të kuotave që do nënshkruhet mes palëve.
3. Depozitimimin e këtij vendimi dhe të marrëveshjes së transferimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), duke autorizuar për këtë qëllim Z. Glen Sakej, mbajtës i kartës së identifikimit me numër personal Nr. J11210049H.

Lexuar, aprovuar e nënshkruar nga aksioneri i vetëm i shoqërisë.

**SHOQËRIA “DIJON ALBANIA” Sh.a.**  
**AKSIONERI I VETËM**  
**DRITAN PASHAKO**



**Marreveshje Transferimi  
te Pjesëve të Kapitalit të shoqërisë “DIJON ALBANIA” Sh.a**

Në Tiranë, sot më 22/03/2023, palët e kësaj Marrëveshjeje ranë dakort si më poshtë:

**Shitësi:**

- **Z. Dritan Pashako**, shtetas shqiptar, lindur më 28.07.1969, në Tiranë e banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal Nr. G90728110F, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

*(më poshtë referuar “SHITËSI”)*

dhe

**Blerësi:**

- **Znj. Emi Gliozheni**, shtetase shqiptare, lindur më 23.12.1986, në Tiranë e banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me numër personal Nr. I662230400, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

*(me poshte referuar “BLERËSI”)*

**Dhënëse Pëlqimi:**

- **Zj. Silvana Pashako**, shtetase shqiptare, lindur më 25/03/1976, në Tiranë e banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me numër personal Nr. H65325217K, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, në cilësinë e bashkëshortes së Z. Dritan Pashako.

**MEQENESE:**

- A. Shitësi zotëron 100% të Kapitalit të Shoqërisë “DIJON ALBANIA” Sh.a, një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve te Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me **NIPT K81805011P**, me seli në: Tiranë, Njesia bashkiake nr 2, sheshi “Avni Rustemi”, vila 3-kateshe (ish vila e Vefes), (“Shoqeria”) me një kapital prej 76.600.000,00 Leke, i përbërë nga 1000 kuota me vlere nominale 76.600,00 lekë secila.
- B. Blerësi dëshiron të blejë 3% të Kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitësi në shoqërinë e lartpërmendur “DIJON ALBANIA” Sh.a. siç percaktohet në këtë marrëveshje.
- C. Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe nenet e Statutit te Shoqërisë, Asambleja e Aksionerëve të shoqërisë ka marrë vendimin përkatës për transferimin tek Blerësi të kuotave si më sipër.

PER SA ME SIPER, palet bien dakort si më poshtë:

1. Shitësi pranon se ka marre nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën nominale të kuotave, prej LEK 2.298.000 (*dy milion e dyqind e nentedhete e tetemije*) dhe për këtë arsye transferojnë këtu 3% të Kapitalit të zotëruar nga Shitësit në Kapitalin e Shoqërisë “DIJON ALBANIA” Sh.a., në pronësi të Blerësit.  
Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se 3% e kapitalit që transferohet këtu është në pronësinë e tyre të plotë ligjore dhe të lira nga barra, hipotekë apo pengje.

2. Blerësi pranon pronësinë e 3% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i këtyre Kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
3. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, të shoqërisë aksionere dhe pjesët e kapitalit të zoteruara prej tyre në shoqërinë "DIJON ALBANIA" Sh.a. do të jenë:
  - **Z. Dritan Pashako**, - zotëron 97% të kapitalit të shoqërisë
  - **Znj. Emi Gliozheni** - zotëron 3% të kapitalit të shoqërisë
4. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të këtyre Kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

#### DHENESE PELQIMI


**Zj. Silvana Pashako** bashkëshorte e Z. Dritan Pashako, aksioner në shoqërinë "DIJON ALBANIA" Sh.a dhe bashkëpronare në kuotën që Z. Dritan Pashako zotëron në shoqërinë "DIJON ALBANIA" Sh.a, për efekt të martesës deklaron se është dakord që 3% të kuotave të kapitalit, objekt i kësaj kontrate, në pronësi të bashkëshortit të saj, t'i shiten Znj. Emi Gliozheni.

Dhënësja e pëlqimit **Zj. Silvana Pashako**, deklaron se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këte vendimmarrje të bashkëshortit të saj për shitjen e 3% të kuotave të kapitalit që zotëron në shoqërinë "DIJON ALBANIA" Sh.a dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me këte shitje.


Kjo Marrëveshje u hartua në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të barabartë ligjore. Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Marrëveshja u lexua nga palët, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lire dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

**SHITESI**  
**Dritan Pashako**



**DHENESE PELQIMI**  
**Silvana Pashako**  
**Bashkeshortja e Shitesit**

Silvana Pashako  


**BLERESI**  
**Emi Gliozheni**

EMI GLIOZHENI  
